

# KONTRATË TIP

MBI VERIFIKIMIN E MATËSAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE VULOSJEN E TYRE

PJESA E PËRGJITHSHME

## PËRMBAJTJA

I.	BAZA LIGJORE.....	3
II.	TË PËRGJITHSHME.....	3
III.	OBJEKTI I KONTRATËS .....	4
IV.	PËRKUFIZIME DHE STANDARDET REFERUESE .....	4
V.	KËRKESAT PËR SAKTËSINË E MATËSAVE .....	9
VI.	VERIFIKIMI FILLESTAR I MATËSAVE ELEKTRIK .....	10
VII.	INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT FILLESTAR.....	11
VIII.	VERIFIKIMI PERIODIK I MATËSAVE.....	11
IX.	INTERPRETIMI I PASAKTËSIVE TË MATËSIT .....	13
X.	VULOSJA E SISTEMIT TË MATJES .....	13
XI.	TË DREJTAT E DETYRIMET E PALËVE .....	15
XII.	AFATI I REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE .....	18
XIII.	DHËNIA E INFORMACIONIT .....	18
XIV.	KONTROLLI DHE SIGURIA NË PUNË.....	18
XV.	MBROJTJA NGA NDËRHYRJET DHE DËMTIMET .....	19
XVI.	MODIFIKIMI I KUSHTEVE TË SHËRBIMEVE .....	19
XVII.	TARIFAT – PAGESA PËR SHËRBIMET.....	19
XVIII.	FATURIMI – PAGESA – PENALITETET .....	20
XIX.	KËRKESA TË TJERA TEKNIKE.....	22
XX.	PLANIFIKIMI.....	22
XXI.	TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE. ....	23
XXII.	FORCA MADHORE.....	24
XXIII.	KONFIDENCIALITETI.....	24
XXIV.	AFATI, HYRJA NË FUQI DHE VLEFSHMËRIA .....	24
XXV.	PËRFUNDIMI, NDËRPRERJA E KONTRATËS .....	25
XXVI.	KALIMI TEK TË TRETËT .....	25
XXVII.	PERSONAT E AUTORIZUAR. NJOFTIMET.....	25
XXVIII.	LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE .....	26
XXIX.	DISPOZITA PËRFUNDIMTARE.....	26
	ANEKSET .....	28

## PJESA E PËRGJITHSHME

### KONTRATË TIP

#### MBI VERIFIKIMIN E MATËSAVE TË ENERGIJISË ELEKTRIKE, DHE VULOSJEN E TYRE

Në Tiranë, sot më datë \_\_\_\_\_/2016, lidhet kjo Kontratë Shërbimi mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre kur futen për herë të parë në treg dhe verifikimin periodik të tyre,

nga dhe ndërmjet:

1. Shoqërisë "....." që ushtron aktivitetin e shpërndarjes ose transmetimit së energjisë elektrike sipas legjislacionit në fuqi ".....". person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në ....., me NUIS ....., i përfaqësuar nga administratori/person i autorizuar ....., këtu e më poshtë i quajtur "Operatori i Rrjetit" dhe,
2. Shoqërisë "-----" person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në \_\_\_\_\_, me NUIS ....., përfaqësuar nga administratori/person i autorizuar z. ...., këtu e më poshtë i quajtur "Ofruesi i Shërbimit" ose "Kontraktori" i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) për verifikimin e aparateve matëse të energjisë elektrike dhe vulosjes së tyre

të cilët, gjithashtu, këtu dhe më poshtë mund të quhen bashkarisht si palët ose veç e veç si pala.

Palët me cilësitë që u njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe vullnet të lirë, bien dakord të nënshkruajnë dhe respektojnë këtë kontratë si më poshtë vijon:

#### I. BAZA LIGJORE

Palët nënshkruajnë këtë kontratë, bazuar në Ligjin Nr.43./2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", Ligjin Nr.9875, datë 14/02/2008 "Për Metrologjinë" i ndryshuar, Kodin e Matjes, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

#### II. TË PËRGJITHSHME

- 2.1 Kjo Kontratë do të përdoret nga Operatorët e Rrjetit për të siguruar dhe rregulluar marrdhëniet ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit të:
  - Verifikimin e matësve elektrik kur futen për herë të parë në treg
  - Verifikimin e matësve elektrik me kërkesë të Operatorit të rrjetit
  - Verifikimin e matësve elektrik me kërkesë të klientit e bërë në formë ankese
  - Verifikimin periodik të matësve elektrik sipas afateve kohore të përcaktuara në Kodin e Matjes
  - Vulosjen e matësve elektrik
  - Bashkëvulosjen e morseterisë së matësit elektik

këtu e më poshtë të quajtura në tërësi Shërbimet e Verifikimit.

- 2.2 Kontrata përmban pjesën e përgjithshme dhe anekset të cilat janë pjesë përbërëse integrale e Kontratës.
- 2.3. Në interpretimin e Kontratës dhe anekseve bashkëngjitur ose shtesave që janë pjesë e saj, termat në vijim do të kenë kuptimin e përkufizimeve sipas Ligjit Nr.43./2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Ligjit Nr.9875, datë 14/02/2008 "Për Metrologjinë" i ndryshuar; Kodit të Matjes, dhe akteve të dala në zbatim të tyre.

### **III. OBJEKTI I KONTRATËS**

Objekt i kësaj kontrate është realizimi i shërbimeve në përputhje me Nenin 77 të Ligjit Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", , si më poshtë:

- 3.1 Verifikimin fillestar të saktësisë të matësave të energjisë elektrike, përpara vënies në përdorim nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar /akredituar
- 3.2 Verifikimin të saktësisë të matësave të energjisë elektrike, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar / akredituar ose në terren, bazuar në kërkesën e operatorit të rrjetit.
- 3.3 Verifikimin të saktësisë të matësave të energjisë elektrike, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar ose në terren, bazuar në ankesën e klientit
- 3.4 Verifikimin periodik të saktësisë të matësave të energjisë elektrike, pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar / akredituar ose në terren.
- 3.5 Verifikimin në terren, të saktësisë të matësave të energjisë elektrike, kur vendosen për herë të parë tek përdoruesi.
- 3.6 Vulosjen e makinerisë të aparatit matës së energjisë elektrike
- 3.7 Bashkëvulosjen e morseterisë të aparatit matës së energjisë elektrike
- 3.8 Palët mund të bien dakort për të kryer shërbime shtesë që lidhen me inspektimin e sistemit të matjes si verifikimi i lidhjeve elektrike të qarqeve sekondare të matjes elektrike, verifikimin e koeficientit të transformimit të transformatorëve të rrymës, kontrollin e izolacionit të pajseve dhe qarqeve elektrike të përfshira në sistemin e matjes, etj. Shërbimet shtesë që mund të kërkohen për qëllime inspektimi do të kryen nga subjekte të autorizuar nga DPM apo të akredituara nga DPA si subjekt inspektues. Tarifat për këto lloj shërbimesh shtesë vendosen në dakortësi midis palëve.

### **IV. PËRKUFIZIME DHE STANDARDET REFERUESE**

#### **3.1 Përkufizime**

Në këtë kontratë termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike, i cili funksionon në përputhje me këtë ligj Nr. 43 /2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- **“Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë”** ose **“DPM”** është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, dhe zhvillon aktivitetin e saj në mbështetje të ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.
- **“Forcë madhore”** është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrafetë, ciklonet, përmytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
- **“Klient”** është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.
- **“Klient familjar”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.
- **“Klient jofamiljar”** janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.
- **“Kodet e Rrjetit”** janë Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Shpërndarjes.
- **“Kodi i Shpërndarjes”** është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.
- **“Kodi i Transmetimit”** është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-e.
- **“Kodi Matjes”** është tërësia e rregullave teknike dhe normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e Energjisë Elektrike, me qëllim për matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.
- **“Sistemi i Matjes së Energjisë Elektrike”** kupton tërësinë e paisjeve të matjes: matësin, automatin, transformatorët e matjes, mbrojtjen e matësit dhe qarqet e lidhjes së tij në rrjet.
- **“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”** ose **“OSSH”** është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficientësinë e energjisë.
- **“Operator i Sistemit të Transmetimit”** ose **“OST”** është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.
- **“Operatori i Rrjetit”** është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.
- **“Person”** është një person fizik ose juridik.
- **“Prodhues”** është një person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike.

- **“Rrjeti e energjisë elektrike”** është tërësia e linjave, nënstacioneve, pajisjeve të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkoneksionit.
- **“Siguri”** është siguria e furnizimit dhe garantimit të energjisë elektrike, si dhe sigurimi teknik.
- **“Sistemi i energjisë elektrike”** është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.
- **“Sistemi i shpërndarjes”** është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
- **“Sistemi i transmetimit”** është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.
- **“Shpërndarje”** është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.
- **“Energji Aktive”** nënkupton energjinë elektrike të prodhuar, që rrjedh ose furnizohet nga një qark elektrik gjatë një intervali kohe, dhe duke qënë pjese e caktuar gjatë një periudhe me fuqi të menjëhershme, matet në vat orë ose Standarde të ndara.
- **“Energji Rektive”** nënkupton integralin e caktuar me kufij kohor të fuqisë reaktive matur në njësi me volt-ampër reaktive—orë ose Standarde të ndara.
- **“Matës Elektrik”** - Nënkupton një pajisje për matjen e energjisë Aktive (import/ekport), energjisë reaktive, energjinë e plotë, fuqisë aktive, fuqisë reaktive, fuqinë e plotë, rrymës, tensionit, faktorit të fuqisë dhe frekuencës.
- **“Pajisja Matëse”** - nënkupton matësa, transformatorë matës për (transformatorët e rrymës dhe të tensionit (TRR & TRT), pajisjet mbrojtëse për matjen ku përfshihen alarmet, lidhjet elektrike si dhe stacionet për mbledhjen e të dhënave që kanë lidhje me keto si dhe përcjellësat që janë pjesë e pajisjeve matëse në vend.
- **“TRR”** nënkupton transformatorët e rrymës
- **“TRT”** nënkupton transformatorët e tensionit.
- **“Matës energjie”** - janë aparate matëse që masin energjinë elektrike nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike në lidhje me kohën respektive.
- **“Matës energjie aktive”** - janë aparate matës që masin energjinë elektrike aktive nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike aktive në lidhje me kohën respektive.
- **“Matës energjie reaktive”** - janë aparate matës që masin energjinë elektrike reaktive nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike reaktive në lidhje me kohën respektive.
- **“Matës elektromagnetik i energjisë Aktive/Reaktive”** - janë aparate matës në të cilët rrymat në bobinat fikse duke vepruar me rrymat e induktuara në elementin lëvizës (diskun e aparatit), shkaktojnë lëvizjen e tij në proporcion me energjinë që matet.
- **“Matës statik i energjisë Aktive/Reaktive”** - janë aparate matës në të cilët rrymat dhe tensionet veprojnë në elementë elektronik për të prodhuar një output proporcional me energjinë që matet.
- **“Qarku i rrymës”** - është një lidhje elektrike e brendëshme në matësin elektrik që është pjesë e elementit të matjes, e cila shërben për kalimin e rrymës së qarkut në të cilin matësi elektrik është lidhur.

- **“Qarku i tensionit”** - është një lidhje elektrike e brendshme në matësin elektrik që është pjesë e elementit të matjes, e cila shërben për furnizimin me tension të matësit elektrik.
- **“Kostantja e matësit të energjisë elektrike”** - është vlera e cila shpreh marrëdhënien ndërmjet energjisë së regjistruar nga matësi dhe vlerës koresponduese të numrit të rrotullimeve të diskut (matës elektromekanik) apo vlerës koresponduese të impulseve të gjeneruara nga instrumenti matës elektronik. Kjo vlerë shprehet në numër rrotullimesh ose numër impulsesh për njësinë e energjisë elektrike të konsumuar.
- **“Regjistri i matësit të energjisë elektrike”** - është pjesë përbërëse e matësit e cila mundëson regjistrimin e vlerës së matur të energjisë elektrike.
- **“Klasa e saktësisë”** - është klasa e matësit të energjisë elektrike që plotëson kërkesat metrologjike të deklaruara, të cilat kanë për qëllim që të mbajnë gabimet e matjes ose pasiguritë e matjes brenda kufijve të përcaktuara nën kushtet e punës specifike.
- **“Lidhje pa transformator matës”** - është lidhja e instrumentit matës elektrik drejtpërdrejt në qarkun elektrik ku do të regjistrojë energjinë elektrike.
- **“Lidhja me transformator matës”** - është lidhja e instrumentit matës elektrik në qarkun elektrik ku do të regjistrojë energjinë elektrike nëpërmjet një ose disa transformatorëve matës të jashtëm.
- **“Rryma e ndjeshmërisë” ( $I_{st}$ )** - është vlera më e vogël e rrymës për të cilin matësi elektrik fillon të regjistrojë energjinë elektrike. [IEC 62052-11,] [EN50470-1]
- **“Rryma nominale për matësat e lidhur pa transformator” ( $I_b$ )** - është vlera e rrymës mbi bazën e të cilës është realizuar performanca e matësit. [IEC 62052-11], [EN50470-1]
- **“Rryma nominale për matësat e lidhur me transformator” ( $I_n$ )** - është vlera e rrymës mbi bazën e të cilës është realizuar performanca e matësit. [IEC 62052-11], [EN50470-1]
- **“Rryma minimale” ( $I_{min}$ )** - është vlera më e vogël e rrymës për të cilën Standardi europian ka specifikuar kërkesat e saktësisë. [EN50470-1].
- **“Rryma e referencës” ( $I_{ref}$ ) (rryma nominale)** - është vlera e rrymës mbi bazën e të cilës është realizuar performanca e kontatorit. [EN50470-1]
  - Për lidhjen e instrumentit matës pa transformator matës ( $I_{ref}=10 \cdot I_{tr}$ ).
  - Kjo vlerë është e njëjta si ( $I_b$ ) e përcaktuar nga IEC 62052-11.
  - Për lidhjen e instrumentit matës me transformator matës ( $I_{ref}=20 \cdot I_{tr}$ ).
  - Kjo vlerë është e njëjta si ( $I_n$ ) e përcaktuar nga IEC 62052-11.
- **“Rryma tranzitore (e ndërmjetme)” ( $I_{tr}$ )** - është vlera e rrymës mbi të cilën aplikohen të gjitha kërkesat e saktësisë të standardit europian. [sipas EN50470-1]
- **“Rryma maksimale” ( $I_{max}$ )** - është vlera më e madhe e rrymës për të cilën matësi elektrik presupozohet të përmbushë kërkesat e saktësisë. [ IEC 62052-11][EN50470-1]],
- **“Tensioni i referencës” ( $U_n$ )** - është vlera e tensionit mbi bazën e të cilës është realizuar performanca e kontatorit. [IEC 62052-11], [EN50470-1]
- **“Frekuenca e referencës” ( $f_{nom}$ )** - është vlera e frekuencës mbi bazën e të cilës është realizuar performanca e matësit. [IEC 62052-11]
- **“Temperatura e referencës”** - është temperatura e ambientit e specifikuar për konditat e referencës.
- **“Gabimi i matjes”** - është tregimi i matësit minus vlerën e vërtetë.
- **“Gabimi relative”** - jepet nga formula e mëposhtme:  
Gabimi në përqindje = (energjia e regjistruar– vlerën e vërtetë)  $\times$  100 / vlerën e vërtetë.
- **“Gabimi maksimal i lejuar”** - është vlera më e madhe e gabimit të matjes, në përputhje me një vlerë reference të njohur, e cila lejohet nga specifikimet ose standardet për një instrument matës apo sistem matjeje.

- **“Sigurimi i të dhënave”** - parandalimi i një ose më shumë pikave të mëposhtme:
  - akses i pa autorizuar në informacion brenda një sistemi të dhënash;
  - alternim i pa autorizuar i informacionit brenda një sistemi të dhënash;
  - prodhim i pa autorizuar i të dhënave që mund të konsiderohen si të vlefshme
- **“Sistemi për Identifikimin e Objekteve OBIS”** - sistemi i cili përcakton kodet e identifikimit për mjetet e të dhënave që përdoren më shumë gjatë matjeve dhe pajisjeve të tjera.
- **“Metrologji”** - është shkenca e matjeve.
- **“Instrument matës”** - është çfarëdo pajisje apo sistem me funksione matëse.
- **“Material referues i çertifikuar”** - është një material referues, i shoqëruar me dokumentacionin e lëshuar nga organizma autoritarë dhe në përputhje me procedurat e vlefshme, të përdorura për të shtuar vlera cilësore specifike me pasiguri dhe transmetueshmëri (gjurmueshmëri).
- **“Etalon referues”** është një etalon që, përgjithësisht, ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.
- **“Kalibrim”** - është tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një masë materiale, si dhe të vlerave të njohura, korresponduese të instrumentit të matur.
- **“Verifikim”** - është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.
- **“Autorizim”** - është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
- **“Çertifikim”** - është veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në standardet përkatëse.
- **“Certifikata e përputhshmërisë”** - Dokumenti i lëshuar sipas rregullave të certifikimit të sistemit, i cili deklaron që është arritur kjo përputhshmëri.
- **“Testimi i përputhshmërisë”** - Ekzaminimi sistematik për të përcaktuar nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara, vecanërisht nga kuptimi metrologjik.
- **Akreditimi** - është procedura në bazë të së cilës një organizëm i autorizuar, vlerëson kompetencën e një organizmi të vlerësimit të konformitetit për të kryer detyra specifike të tilla si testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim. Kompetenca është çelësi për të siguruar transparencën, besueshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ofrojnë Organizmat Vlerësimit të Konformitetit të Akredituara .
- **“Inspektim”** - është shqyrtimi i një produkti, shërbimi, procesi ose sistemi matës, me anë të përcaktimit të përputhjes së tyre me kërkesat specifike ose në bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.

### 3.2 Standardet referues

Kontrolli i aparateve matës të energjisë elektrike do të kryet konform në përputhje me metodikat dhe Standardet dhe aktet e mëposhtme:

- **DPM**  
Procedurat në lidhje me verifikimin e matësve të energjisë elektrike
- **ERE**  
Kodi i Matjes
- **IEC 62052-11:2003**  
Electricity metering equipment (AC) - General requirements, tests and test conditions - Part 11: Metering equipment
- **IEC 62053-11:2003**  
Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 11: Electromechanical meters for active energy (classes 0.5, 1 and 2)



- **IEC 62053-21:2003**  
Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 21: Static meters for active energy (classes 1 and 2)
- **IEC 62053-22:2003**  
Electricity metering equipment (a.c.) - Particular Requirements - Part 22: Static meters for active energy (classes 0.2 S and 0.5 S)
- **IEC 62053-23:2003**  
Electricity metering equipment (a.c.) - Particular requirements - Part 23: Static meters for reactive energy (classes 2 and 3)
- **EN 50470-1:2006**  
Electricity metering equipment (a.c.). General requirements, tests and test conditions. Metering equipment (class indexes A, B and C)
- **EN 50470-2:2006**  
Electricity metering equipment (a.c.). Particular requirements. Electromechanical meters for active energy (class indexes A and B)
- **EN 50470-3:2006**  
Electricity metering equipment (a.c.). Particular requirements. Static meters for active energy (class indexes A, B and C)
- **Directive 2004/22/EC**  
Of the European Parliament and of the Council of 31 March 2004 on measuring instruments (applicable from 2006-10-30)
- **Directive 2006/32/EC**  
Directive of the European Parliament and of the Council of 5 April 2006 on energy end-use efficiency and energy services and repealing Council Directive 93/76/EEC
- **ISO 2859-1:1999/Cor 1:2001**  
Sampling procedures for inspection by attributes Part 1: Sampling schemes indexed by acceptance quality limit (AQL) for lot-by-lot inspection
- **IEC/EN 61557**  
Electrical safety in low voltage distribution systems up to 1000 V a.c.
- **ISO/IEC 17025**  
General requirements for the competence of testing and calibration laboratories
- **EN ISO/IEC 17020:2012**  
Conformity assessment -- Requirements for the operation of various types of bodies performing inspection
- **International Vocabulary of Metrology**  
Basic and General Concepts and Associated Terms (VIM 3rd edition) JCGM 200:2012

## V. KËRKESAT PËR SAKTËSINË E MATËSAVE

- 5.1 Operatori i Rrjetit nuk ka të drejtë të testoi matësa apo të instaloj matësa të testuar duke përdorur laborator në pronësi të tij.
- 5.2 Verifikimi fillestar dhe periodik në kushte laborator apo në terren do të kryet vetëm nga subjektet e autorizuara ose të akredituara sipas Legjislacionit në fuqi.
- 5.3 Subjektet e autorizuara për verifikimin e sistemit të matjes së energjisë elektrike duhet të përdorin vetëm matësa standard referues etalon ose/dhe instrumenta portativë testimi të pajisur me certifikatë kalibrimi të lëshuar nga laboratorë të akredituar me EN ISO/IEC 17025
- 5.4 Verifikimi për klasën e saktësisë së matësit elektrik mund të kryhet në kushte laborator me stenda dhe në terren duke përdorur instrumenta etalon referues portativë me klasë

saktësie  $\pm(0.05\div 0.5)\%$ , të cilët duhet të jenë kalibruar nga DPM ose nga laboratorë të akredituar me Standardin EN ISO/IEC 17025.

- 5.5 Para instalimit fillestar dhe gjatë verifikimit periodik ose çdo lloj testi tjetër matës elektrik duhet të testohen që të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
- a. Çdo matës që ka një gabim në matje mbi/nën vlerat e gabimit maksimal/minimal të lejuar të parashikuara në Standardin IEC/EN për llojin dhe klasën e saktësisë së matësit, duhet të zëvendësohet me matës të testuar paraprakisht dhe të rregullt që të qëndrojë në shërbim.
  - b. Kurdo qoftë një matës që kalon këto limite, qoftë edhe në një pikë ngarkese matjeje, ai duhet të zëvendësohet me matës tjetër të verifikuar paraprakisht ose që mund të verifikohet në terren në momentin e zëvendësimit.
  - c. Për matës elektrik që testohen në terren toleranca e gabimit maksimal të lejuar në matje do të jetë 1.5 herë klasa e saktësisë së vetë matësit elektrik.

## **VI. VERIFIKIMI FILLESTAR I MATËSAVE ELEKTRIK**

- 6.1. Operatori i Rrjetit siguron verifikimin fillestar të matësve elektrik duke e shpërndarë sasinë e matësve elektrik të livruar në mënyrë të barabartë midis subjekteve të autorizuara ose akredituara. Operatori i Rrjetit do të dërgoi për testim nga loti i matësve të dorëzuar një sasi të zgjedhur prej sasisë totale të livruar nga furnizuesi.
- 6.2. Testimet do të kryhen paraprakisht duke përdorur sistemin me zgjedhje rastësore, dhe do të realizohen në përputhje me standardet e specifikuara IEC 62053, EN 50470, etj.
- 6.3. Testimet që do të verifikojnë nëse matësi elektrik punon në nivelet e saktësisë sipas kërkesave të përshkruara në standardet IEC 62053, EN 50470 dhe procedurat e miratuara nga DPM, do të realizohen nga një person juridik i pavarur i autorizuar/ i akredituar me Standardin ISO/IEC 17025.
- 6.4. Testimet që do të realizohen nga subjekti i pavarur i autorizuar /akredituar janë këto:
  - a) Testimi i qëndrueshmërisë elektrike
  - b) Testimi i ndjeshmërisë
  - c) Testimi pa ngarkesë
  - d) Testimi i ngarkesës
  - e) Testimi i konstantes
- 6.5. Testimi i qëndrueshmërisë elektrike të matësve të energjisë elektrike kryhet vetëm në kushte laborator.
- 6.6. Të gjithë matësat e rinj që instalohen tek klienti do të verifikohen përpara instalimit nëse gabimi i matjes së tyre është brenda tolerancave të parashikuara në standarde dhe Kodin e Matjes. Matësat elektrik që janë pjesë e furnizimit nga prodhuesi për të cilët është realizuar verifikimi me metodikën e përzgjedhjes rastësore mund të instalohen pa kryer verifikimin individual të secilit matës, por duhet të përfshihen në verifikimin periodik sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Matjes. Në rastet kur Operatori i Rrjetit instalon tek klienti matësa elektrik pa verifikimin paraprak por që janë pjesë e matësve të verifikuar me përzgjedhje, atëherë Operatori i Rrjetit mban përgjegjësi për rregullshmërinë e saktësisë së matësit elektrik kurse subjekti i autorizuar ose akredituar përjashtohet nga kjo lloj përgjegjësie.

- 6.7. Matësat elektrik të klasës 0.5, 1, 2, A, B, C do të verifikohen nga subjektet e autorizuar nga DPM dhe/ose të akredituara si laborator testues të pavarur të akredituar me Standardin EN ISO/IEC 17025 ku fusha e akreditimit mbulon këto klasa saktësie.
- 6.8. Matësat elektrik të klasës 0.2S, 0.5S, 0.5 dhe C, përpara se të vendosen në punë, do të kalibrohen nga DPM ose laboratorë kalibrues të pavarur të akredituar me standardin për kalibrim EN ISO/IEC 17025 ku fusha e akreditimit mbulon këto klasa saktësie.
- 6.9. Verifikimi i matësve elektrik nga subjektet e pavarura do të kryhet sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në kontratën tip të miratuar nga ERE.

## **VII. INTERPRETIMI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT FILLESTAR**

- 7.1 Një sasi e caktuar e zgjedhur në formë rastësore , prej sasisë totale të matësve elektrik që parashikohet të livrohen sipas kontratave të blerjes, do të nënshtrohen testimi me qëllim verifikimi. Përzgjedhja e matësve që do të testohen do të jetë rastësore si pjesë e shumës së dorëzuar. Zgjedhja e mostrave për testimin verifikues kryhet nga Operatori i Rrjetit.
- 7.2 Procedurat e vlerësimit të konformitetit përcaktohen në MID-Measuring Instruments Directive (2004/22/EC) si edhe ISO 2859.
- 7.3 Procedura e marrjes së mostrave dhe interpretimi i tyre do të bëhet në bazë të Standardit IEC ISO 2859, duke përdorur kriterin që sistemi i testimeve të matësve të zgjedhur si provë duhet të garantojë një nivel cilësie pranimit (AQL) prej jo më shumë se 1%; (AQL është përqindja maksimale e artikujve të papajtueshëm në një lot, ku loti ka 95% probabilitet për t'u pranuar).
- 7.4 Rezultatet e provës do të jenë interpretime sipas ISO 2859-1:1999/Cor 1:2001 "Procedurat e marrjes së kampionëve për inspektim sipas veçorive - Pjesa 1: Skemat e marrjes së kampionëve të indeksuar sipas limit të cilësisë së pranimit (AQL) për kontrollin lot pas loti".
- 7.5 Kriteret e pranimit të matësve të rinj elektrik të livruar nga prodhuesi për çdo dërgesë (lot) me metodikën e përzgjedhjes paraqiten në Aneksin 23.

## **VIII. VERIFIKIMI PERIODIK I MATËSAVE**

- 8.1 Verifikimi periodik i matësve elektrik do të kryhet nga subjekte të pavarura të autorizuar nga DPM dhe/ose të akredituara.
- 8.2 Matësat elektrik do të testohen në kushte laborator por edhe në kushte terreni duke përdorur matës referues kontrolli ose instrumenta portative testimi të pajisur me certifikatë konformiteti të certifikuar nga laboratorë të akredituar me Standardin EN ISO/IEC 17025.
- 8.3 Metodika e testimi do të jetë ajo e krahasimit të rezultateve të matjeve me ato të regjistruara nga një matës standard etalon me klasë saktësie me të lartë se klasa e saktësisë së matësit elektrik që do të testohet.
- 8.4 Objektet e verifikimit do jenë të gjithë matësat elektrik të klientëve fundor familjar; klientëve fundor jofamiljar, matësat e bilancit elektrik në bokse kolektive si edhe matës elektrik të vendosur në nënstacione elektrike që i përkasin klientëve jofamiljar të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në nënstacion. Matësat elektrik të nënstacioneve që lidhen me bilancin energjitik të operatorit të rrjetit nuk do të jenë subjekt i kësaj kontrate, por mund të trajtohen midis palëve sipas pikës 3.8.

- 8.5 Tolerancat e gabimit të matësit që testohet në kushte laboratorit do të jenë në përputhje me klasën e tij si edhe kufirin e tolerancave të gabimeve të parashikuar në Standardet IEC/EN. Nëse gjatë testimit, gabimi qoftë edhe në një pikë ngarkesë rezulton më e lartë se toleranca e gabimit të parashikuar në IEC/EN, atëherë matësi do të konsiderohet jo i rregullt.
- 8.6 Tolerancat e gabimit të matësit që testohet në kushte terreni do të jenë 1.5 herë klasën e sakësisë së vetë matësit elektrik.
- 8.7 Matësat që rezultojnë të rregullt pas verifikimit do të vulosen me vulë dhe një çift etiketash sigurie. Matësat që rezultojnë jo të rregullt do të identifikohen me anën e një çift etiketash sigurie që tregojnë se matësi është jo i rregullt.
- 8.8 Vulat dhe etiketat e sigurisë duhet të jenë paraprakisht të miratuara nga DPM
- 8.9 Vula dhe etiketa duhet të mbetet e padëmtuar në mënyrë që matësi të ketë statusin e plotë të të qënit i verifikuar.
- 8.10 Në rast ndërhyrje në matës ose në sistemin e matjes, vula dhe etiketa duhet të dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme dhe lehtësisht e identifikueshme
- 8.11 Matësat e hequr nga funksionimi duhet të testohen përsëri përpara rilidhjes të tyre për përdorim.
- 8.12 Të gjithë matësat dhe pajisjet e tjera të sistemit të matjes, do të jenë të testuar për saktësinë e tyre përpara se të vihen në punë. Testimet duhet të bëhen në periudha të caktuara kohore për të kontrolluar dhe verifikuar që funksionimi i matjes është brenda kufijëve të lejuar të gabimit të dhënë në Kodin e Matjes.
- 8.13 Të gjitha Palët duhet të informohen për testet, të jenë të ftuar për të marrë pjesë dhe rezultatet e këtyre testeve të jenë në dispozicion të çdo Pale.
- 8.14 Testet duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të minimizohen dhe të shmangen ndërprerjet e matjes së Energjisë Elektrike ku pajisjet janë instaluar.
- 8.15 Për kryerjen e testeve periodike në terren mund të përdoren edhe instrumenta portativë të kalibruara nga DPM ose nga laboratorë të akredituar me EN ISO/IEC 17025 dhe klasa e saktësisë së instrumentave portativ të tyre duhet të jetë (0.05-0.3)%. Për këto raste do të realizohen matje të ndryshme të gabimit të matësit elektrik në të paktën tre rregjime ngarkese të ndryshme dhe do të evidentohet në raportin e testimit gabimi mesatar.
- 8.16 Operatori i Rrjetit ka detyrë të riparojë lidhjet e qarqeve elektrike, nëse gjatë verifikimit nga subjekti i autorizuar rezulton fazim ose diagram vektoriale jo e rregullt e matësit elektrik.
- 8.17 Operatori i Rrjetit mban përgjegjësi për saktësinë e transformatorëve të rrymës dhe tensionit, koeficientin e tyre të transformimit si dhe parametrat e vendosur në matës për efekt të llogaritjes së energjisë elektrike të konsumuar nga përdoruesi.
- 8.18 Subjektet e autorizuar / akredituara nuk do të kryejnë ekspertizë në lidhje me gjendjen apo mundësinë e ndërhyrjes tek vulat e sigurisë së vendosura nga Operatori i Rrjetit ose subjekte të tjera të autorizuar, por do të evidentojnë vetëm nëse vulat apo etiketat e sigurisë së vendosur nga ana e vetë subjektit të autorizuar/akredituar janë cënuar apo jo.

- 8.19 Operatori i Rrjetit dhe subjektet e pavarura të autorizuar/akredituara mund të bien dakort midis tyre që subjektet të kryejnë në terren edhe shërbime me qëllim inspektimi të sistemit të matjes për identifikimin e anomalive dhe evidentimin e tyre (fazorenditja, diagrama vektoriale, inspektimi i ndërhyrjeve të qëllimshme në matësin elektrik me qëllim përfitimi ose abuzimi, identifikimi i rregullshmërisë së lidhjeve elektrike, etj) duke përfshirë edhe testimin e matësit elektrik. Inspektimi i sistemit të matjes në terren do të kryhet duke përdorur instrumenta etalon portativë të kalibruar nga laboratorë të pavarur të akredituar me Standardin ISO/IEC 17025 dhe shërbimi do të konsiderohet dhe raportohet si shërbim verifikimi i matësit elektrik në terren pavarësisht shërbimeve të tjera që do të kryhen si më sipër.

## **IX. INTERPRETIMI I PASAKTËSIVE TË MATËSIT**

- 9.1 Kur pas verifikimit konstatohen se gabimi i regjistruar pas testimit është përtej gabimit maksimal të lejuar dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga klienti, atëherë Operatori i Rrjetit kryen përlogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, sipas rezultatit të pasaktësisë në matës dhe në këtë mënyrë bëhet rimbursimi sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
- 9.2 Rregullimet për pasaktësitë e matjeve do të kufizohen për periudhën e fundit 12 mujore dhe sa herë që konstatohet nga subjektet e autorizuar për kryerjen e testimit të matësive elektrik, që matësi i kalon kufijtë e tij të saktësisë të përcaktuara (minus ose plus), atëherë do të aplikohet procedura e kompensimit e mëposhtme:
- Në rastin kur kemi rezultate që vërtetojnë se matësi nuk bën matje të saktë të energjisë elektrike dhe gabimi i kalon kufijtë e përcaktuar në këtë Rregullore dhe klienti ka paguar më pak (gabimi i testimit është negativ) , atëherë klienti është i detyruar të paguajë diferencën e vlerës për 12 muaj të mëparshëm duke filluar prej ditës kur është bërë verifikimi.
  - Në rastin kur kemi rezultate që vërtetojnë se matësi nuk bën matje të saktë të energjisë elektrike dhe gabimi i kalon kufijtë e përcaktuar në këtë Rregullore dhe klienti ka paguar më shumë ( gabimi i testimit është pozitiv) , atëherë Operatori i Rrjetit është i detyruar të paguajë diferencën e vlerës për 12 muaj të mëparshëm duke filluar prej ditës kur është bërë verifikimi.
  - Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte laborator, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbej diferenca midis gabimit që rezulton në matës pas testimit dhe gabimit maksimal të lejuar të llogaritur në pikën referuese të ngarkesës si më poshtë:
    - Matësa 1(një) fazorë :  
Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100%$ , për  $\cos\phi=1$
    - Matësa 3(tre) fazorë :  
Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100%$  (L1,L2,L3) për  $\cos\phi=1$
  - Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte terreni me instrumenta portative, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbej diferenca midis gabimit që rezulton në matës pas testimit me 1.5 herë klasën e matësit.

## **X. VULOSJA E SISTEMIT TË MATJES**

- 10.1 Pajisjet e sistemit të matjes duhet të jenë të instaluar në kuti individuale (boks individual), ose panel kolektiv (boks kolektiv) ose çelë matje (kur matja kryhet në T.M) dhe të

vendosura në ambiente të veçanta apo në vende ku mund të lexohen qartë dhe lehtësisht të kontrollueshëm nga përfaqësues të autorizuar nga Operatori i Rrjetit. Treguesi (ekrani) i matësit duhet të jetë gjithmonë i pastër dhe i dukshëm.

- 10.2 Pajisjet e sistemit të matjes duhet të jenë të lehta për tu vulosur për ti mundësuar Operatorit të Rrjetit apo subjekteve të autorizuar vulosjen e elementëve me vula.
- 10.3 Operatori i Rrjetit dhe subjekti i autorizuar do të bëjnë bashkëvulosjen e morseterisë së aparatit matës me vula të veçanta të palëve.
- 10.4 Subjekti i autorizuar do të vendosë edhe një çift etiketash sigurie në makinerinë e aparatit matës për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen e tij nga abuzuesit e mundshëm.
- 10.5 Si rregull matësi elektrik nuk do të bashkëvuloset morseteria nëse matësi elektrik nuk është verifikuar paraprakisht nga subjektet e pavarura të autorizuar/akredituara. Kryerja e verifikimit të matësit elektrik dëshkohet nëpërmjet pranisë së vulave të makinerisë dhe etiketave të sigurisë në makinerinë e vetë matësit elektrik.
- 10.6 Për matësat e rinj, nëse verifikimi paraprak i tyre nuk është bërë në kushte laborator, mund të verifikohen në terren përpara vënies në punë dhe më pas të bashkëvulosen nga Operatori i Rrjetit dhe nga subjektet e autorizuar/akredituara.
- 10.7 Operatori i Rrjetit mund të instalojë matësa elektrik të pa verifikuar nga subjektet e autorizuar nëse instalimi është për herë të parë tek klienti dhe nëse matësi elektrik është pjesë e matësive elektrik të cilët janë kontrolluar me metodikën e zgjedhjes. Në këto raste subjekti i autorizuar realizon vetëm bashkëvulosjen e morseterisë së matësit elektrik dhe nuk mban përgjegjësi në lidhje me saktësinë e matësit elektrik të instaluar në këtë formë.
- 10.8 Ndërhyrjet në pajisjet e sistemit të matjes dhe vulat, do të bëhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga Operatori i Rrjetit në prezencë të klientit.
- 10.9 Operatori i Rrjetit periodikisht, duhet të bëjë kontroll për vulosjen e sistemit të matjes si dhe të gjendjes së vulave të paktën një herë në muaj, kur kryhet leximi i regjistrimit të matësit elektrik.
- 10.10 DPM miraton tipin e vulave të sigurisë që do përdoren nga Operatori i Rrjetit dhe subjektet e autorizuar/akredituara që kryejnë shërbimin e verifikimit dhe bashkëvulosjes së sistemit të matjes.
- 10.11 Vulosja nëpërmjet vulës së sigurisë bëhet me tel çeliku të viaskuar dhe galvanizuar.
- 10.12 Në çdo matës elektrik vendosen minimalisht dy vula sigurie në morseterinë e tij, pasi nëpërmjet procesit të bashkëvulosjes, një vulë vendoset nga subjekti i autorizuar që kryen verifikimin e matësit elektrik dhe një vulë vendoset nga Operatori i Rrjetit.
- 10.13 Vulosja duhet të kryhet në pikat e mëposhtme (të zbatueshme):
  - Transformatori i rrymës (Operatori i Rrjetit)
  - Transformatori i tensionit (Operatori i Rrjetit)
  - Boksi individual njëfazore (Operatori i Rrjetit)
  - Bokse kolektive (Operatori i Rrjetit)
  - Panele matje me matës dhe transformator rryme (Operatori i Rrjetit)
  - Makinaria e matësit (Subjekti i pavarur)
  - Morseteria e matësit (Operatori i Rrjetit dhe subjekti i pavarur)
  - Butoni i vendosjes së parametrevave të matësit (Operatori i Rrjetit)

- Blloku i testimit të matësit (Operatori i Rrjetit)
  - Çelë matje (Operatori i Rrjetit)
  - Etj.
- 10.14 Pas procesit të verifikimit të matësit elektrik apo sistemit të matjes, subjektet e autorizuar vendosin një çift etiketash sigurie me të njëjtin numër serial (çift unik), për të siguruar makinerinë e matësit nga ndërhyrjet abuzive.
- 10.15 Çifti i etiketave të sigurisë me të njëjtin numër serial, që vendosen nga subjektet e pavarura gjatë verifikimit të matësit elektrik, do të konsiderohet si një vulë sigurie më vete.
- 10.16 Etiketat e sigurisë që përdoren duhet të jenë me logon e subjektit që ka realizuar vendosjen e saj, duhet të kenë numër serial, barkode, dhe të jenë me një përdorim duke u vetëshkatërruar ose duke lënë shenjë të dukshme VOID nëse hiqen nga matësi elektrik pas vendosjes nga subjekti gjatë verifikimit të matësit apo sistemit të matjes.
- 10.17 Nëse gjatë verifikimit në terren subjekti i autorizuar nuk është në gjendje të gjykojë mbi saktësinë e matësit elektrik, atëherë ai kërkon që matësi elektrik të testohet në kushte laborator. Kjo kërkesë dëshmohet duke vendosur nga ana e tij etiketa sigurie Ri-Testime laborator.
- 10.18 Operatori i Rrjetit është i detyruar t'i dorëzojë Ofruesit të Shërbimit, 30 ditë përpara një plan ku do të instalohen matësat që do të bashkëvulosen, përndryshe çdo kërkesë e bërë nga ana e Operatorit të Rrjetit jashtë këtij afati nuk do të konsiderohet nga ana e ofruesit të shërbimit.

## **XI. TË DREJTAT E DETYRIMET E PALËVE**

### **11.1 Të përgjithshme**

- 11.5.1 Palët do të bashkërendojnë programin e punës për realizimin praktik të objektit të Kontratës, duke ngritur strukturat përkatëse për koordinim, bashkërendim dhe –organizimin e punës. Palët mbajnë përgjegjësi reciproke për zbatimin në kohë të këtij programi
- 11.5.2 Palët kanë të drejtë të lidhin kontratë për disa ose të gjitha shërbimet e parashikuara në objektin e kontratës tip, të parashikuar në nenin 3.1.
- 11.5.3 Palët bien dakort midis tyre në rast se kërkojnë të kryejnë shërbime të tjera veç atyre të parashikuara në këtë kontratë.
- 11.5.4 Informacioni i ruajtur nga secila palë do t'i jepet palës tjetër, së cilës i është dhënë e drejta ta përdorë këtë informacion në masën e përcaktuar në këtë kontratë. Kontraktori do të krijojë arkivën fizike dhe elektronike sipas standardeve të legjislativës në fuqi.
- 11.5.5 Palët kanë detyrimin që:
- të njoftojë njëra tjetrën për çdo situatë parregullsie të konstatuar nga autoritetet shtetërore të kontrollit, si dhe për çdo pezullim apo heqje të lejeve/licensave, autorizimeve etj., që kanë të bëjnë me shërbimet e kontrollit;
  - të njoftojë menjëherë Shpërndarësin për procedim ligjor që ka për objekt shërbimet e kontrollit, përjashtuar ato të përcaktuara me ligj;

- të mbajë të informuar Shpërndarësin për zhvillimet në situatat dhe procedimet e lartpërmendura.

## 11.2 Detyrimet e Operatorit të Rrjetit

Operatori i Rrjetit ka detyrim që:

- 11.2.1 Në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Ligj dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) duke siguruar që brenda afateve për verifikimin periodik të përcaktuara në Kodin e Matjes, të verifikohen të gjithë matësat elektrik në përdorim
- 11.2.2 Të krijojë struktura të veçanta që do të angazhohen dhe do të jenë përgjegjëse vetëm për shërbimin e verifikimit të matësave elektrik. Këto struktura të Operatorit të rrjetit nuk do të kryejnë detyra të tjera përveç verifikimit të matësave elektrik.
- 11.2.3 Shërbimet e ndërprerjes së energjisë elektrike apo të tjera si këto nuk kanë lidhje me verifikimin periodik të matësave dhe nuk duhet të jenë pjesë e planifikimit ditor të punës nga ana e Operatorit të Rrjetit. Kontrolli i aparatit matës të disa klientëve që paraqesin dyshime, do të realizohen sipas një plani javor në dakortësi midis palëve, por prioritet do të jetë gjithmonë realizimi i planit të verifikimit periodik.
- 11.2.4 Të bashkëpunojë me strukturat e subjektit të pavarur të autorizuar/akredituar për të siguruar realizimin e planit të shërbimeve mujore dhe vjetore. Subjektet e autorizuar janë të pavarura dhe nuk janë as pjesë e strukturës administrative të Operatorit të Rrjetit dhe nuk janë as në varësi të Operatorit të Rrjetit.
- 11.2.5 Është përgjegjës për dërgimin në laborator për shërbim të verifikimit fillestar vetëm të tipit të matësave të cilët janë pranuar nga DPM për t'u futur për herë të parë në treg.
- 11.2.6 Garanton kushte normale organizative e teknike për grupet e punës për të siguruar efektivitet dhe realizim të programit të punës së miratuar. Grupet e punës së krijuar nga Operatori i Rrjetit duhet të jenë të emëruara dhe të dedikuara vetëm për të kryer shërbimin e verifikimit të matësave elektrik.
- 11.2.7 Ka detyrimin t'i sigurojë kontraktorit akses të plotë e të sigurtë në të gjitha zonat dhe ambientet ku duhet të kryhen shërbimet e verifikimit.
- 11.2.8 Sipas planit grafikut, Operatori i Rrjetit sjellë në laboratorin e Kontraktorit matësat e energjisë elektrike dhe kryen dorëzimin e dokumentacionit të tyre për verifikim, dhe vulosje . Operatori i Rrjetit është përgjegjës për transportimin dhe kushtet e realizimit të tij, në mënyre që të mos dëmtohen matësat elektrike. Nëse transportimi do të kryet nga Kontraktori, atëherë Operatori i Rrjetit do të njohë edhe shpenzimet respektive të transportit.
- 11.2.9 Të verifikojë ekzistencën e verifikimit dhe vulosjes së makinerisë së matësit nga laboratorin i autorizuar para kryerjes së instalimit të matësit tek përdoruesi. Matësi elektrik nuk do të instalohet tek klienti nëse ai nuk është i verifikuar paraprakisht nga subjektet e autorizuar nga DPM.
- 11.2.10 Të mos kryejë vulosjen e morseterisë së matësit pa siguruar në të njëjtën kohë bashkëvulosjen e saj edhe nga subjekti i autorizuar nga DPM.



- 11.2.11 Të mos modifikojë apo dëmtojë vulat e vendosura nga Kontraktori.
- 11.2.12 Të riparojë lidhjet e qarqeve elektrike, nëse gjatë verifikimit nga kontraktori, rezulton fazim ose diagram vektoriale jo e rregullt.
- 11.2.13 Të zëvendësojë menjëherë matësat elektrikë, që rezultojnë jo të rregullt, gjatë kontrollit në terren.
- 11.2.14 Mban përgjegjësi për saktësinë e transformatorëve të rrymës dhe tensionit, koeficientin e tyre të transformimit si dhe parametrat e vendosur në matës për efekt të llogaritjes së energjisë elektrike të konsumuar nga përdoruesi.
- 11.2.15 Mban përgjegjësi për realizimin e planit mujor të shërbimeve të miratuar nga DPM dhe nëse për një periudhë të caktuar kohe plani mujor nuk realizohet, atëherë mosrealizimi do të plotësohet në muajin në vazhdim.

### **11.3 Detyrimet e Kontraktorit**

Kontraktori ka detyrim që:

- 11.3.1 Të kryejë dhe përmbushë shërbimet dhe detyrimet e tij në përputhje me kërkesat e standarteve teknike të parashikuara në këtë kontratë dhe sipas formularëve në aneksin e kësaj kontrate.
- 11.3.2 Të kryejë verifikimin, dhe vulosjen e makinerisë së matësave të energjisë elektrike që rezultojnë të rregullt, duke përdorur një vulë makinerie dhe dy etiketa sigurie. Për matësat elektrik që rezultojnë të rregullt pas verifikimit, kontraktori do të heq të gjitha vulat dhe etiketat e mëparshme duke vendosur vula dhe etiketa sigurie të reja.
- 11.3.3 Për matësat e energjisë elektrike që rezultojnë nga testimi si jo të rregullt nuk bëhet vulosje e makinerisë së tyre, por vendosen dy etiketa sigurie që vërtetojnë se matësi është jo i rregullt. Vulat dhe etiketat e mëparshme nuk do të hiqen nga matësi elektrik i cili pas verifikimit rezulton jo i rregullt.
- 11.3.4 Të mos bashkëvulosë matësa në terren, në se matësat nuk janë të verifikuar më parë nga subjektet e autorizuar nga DPM me përjashtim të rasteve nëse instalimi është për herë të parë tek klienti dhe nëse matësi elektrik është pjesë e matësave elektrik të cilët janë kontrolluar me metodikën e zgjedhjes. Në këto raste subjekti i autorizuar nuk mban përgjegjësi në lidhje me saktësinë e matësit elektrik të instaluar por mban përgjegjësi vetëm për vulosjen e morseterisë.
- 11.3.5 Kryerja e shërbimeve nga Kontraktori do të evidentohet nëpërmjet dorëzimit të formularëve në aneksin e kësaj kontrate.
- 11.3.6 Kontraktori përgatit dhe ruan të dhënat e rezultateve të verifikimit në arkiv dhe përgatit dokumentin e dorëzimit sipas formularëve në Aneksin e kësaj kontrate.
- 11.3.7 Subjektet e autorizuar për verifikimin e matësave elektrik nuk mbajnë përgjegjësi në se Shpërndarësi ju dërgon për verifikim matësa të cilat nuk janë miratuar paraprakisht nga DPM për t'u futur për herë të parë në treg.
- 11.3.8 Vulat dhe etiketat e përdorura nga kontraktori do të kenë elementë sigurie dhe në rast ndërhyrje në matësin elektrik, vula dhe etiketa duhet të dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme dhe dëmtimi/ndërhyrja duhet të jetë lehtësisht e identifikueshme. Vulat e sigurisë miratohen paraprakisht nga DPM.

## **XII. AFATI I REALIZIMIT TË SHËRBIMEVE**

- 12.1 Shërbimi i verifikimit fillestar të matësave në kushtë laboratorit duhet të realizohet brenda 5 ditëve pune nga momenti i dorëzimit për verifikim të partisë (sasisë) së matësave të energjisë elektrike, kur sasia e matësave të dorëzuar është deri në 1000 copë për matësa një fazorë dhe deri në 300 copë për matësa tre fazorë. Nëse sasia e matësave të dorëzuar do të jetë më e madhe atëherë do të përdoret kapaciteti njësi ditore përkatësisht 200 matësa/ditë një fazorë dhe 60 matësa/ditë tre fazorë.
- 12.2 Shërbimi i verifikimit periodik të matësave në kushtë laboratorit duhet të realizohet brenda 5 ditëve pune nga momenti i dorëzimit për verifikim të partisë (sasisë) së matësave të energjisë elektrike, kur sasia e matësave të dorëzuar është deri në 200 copë për matësa një fazorë dhe deri në 60 copë/ditë për matësa tre fazorë.
- 12.3 Shërbimi i verifikimit në terren me instrumenta portativë ose/edhe shërbimi i bashkëvulosjes do të kryhet në të njëjtën ditë kur është planifikuar të kryhet ky shërbim nga Operatori i Rrjetit
- 12.4 Afatet e verifikimit në laborator të matësave që përbëjnë ankesë nga përdoruesit do të jenë të njëjta me ato të pikës 12.2.

## **XIII. DHËNIA E INFORMACIONIT**

- 13.1 Operatori i Rrjetit ka detyrimin t'i sigurojë e t'i vendosë në dispozicion Kontraktorit të gjithë dokumentacionin dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me matësat e energjisë një fazorë dhe tre fazorë, të klasës së saktësisë 0.5, 1, 2 A, B dhe C të përdorur prej tij.

## **XIV. KONTROLLI DHE SIGURIA NË PUNË**

- 14.1 Në përputhje me legjislacionin për sigurinë në punë dhe parandalimin e aksidenteve, Operatori i Rrjetit ka detyrimin t'i sigurojë Kontraktorit me informacionin e plotë e të detajuar në lidhje me risqet specifike ekzistues në vendet ku do të kryhet shërbimi nga punonjësit e kompanive, që realizojnë shërbimin e kontrollit.
- 14.2 Palët, gjithashtu kanë detyrimin, të bashkëpunojnë dhe koordinojnë përsa i përket zbatimit të rregullave të sigurimit teknik për shmangien e rrezikut në punë dhe parandalimin e aksidenteve, që ndikojnë në punën e kompanive.
- 14.3 Operatori i Rrjetit është përgjegjës për tokëzimin e sistemit të matjes, kontrollin dhe mirëmbajtjen e tij, në përputhje me kërkesat e sigurimit teknik dhe kushteve teknike të punës së pajisjeve.
- 14.4 Operatori i Rrjetit duhet të sigurojë që çdo matës elektrik është i pajisur me automat mbrojtës përndryshe lidhja e matësit elektrik do të konsiderohet jo e rregullt dhe kontraktori nuk do të kryej shërbimin e verifikimit të këtyre matësave elektrik. Lidhja e automatit bëhet përpara matësit elektrik duke mbrojtur klientin dhe matësin elektrik.
- 14.5 Bokset individuale duhet të jenë të tokëzuar me elektrodë tokëzimi të veçantë duke realizuar rezistencën e tokëzimit në vlerë të parashikuar nga Rregullorja e Sigurimit Teknik dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Instalimet dhe Pajisjet Elektrike dhe IEC/EN 61557 – “Electrical safety in low voltage distribution systems up to 1000 V a.c.”

- 14.6 Të gjitha linjat dhe aparatet e furnizimit me energji elektrike duhet të kenë fuqi të mjaftueshme për të bërë përshkallëzimin, izolimin dhe vlerësimin e defektit të rrymës dhe të fuqisë së mjaftueshme mekanike, për detyra të cilat mund të kërkojnë të kryhen sipas kushteve të vendit ku është bërë instalimi, dhe duhet të ndërtohen, instalohen, mbrohen, punohen dhe mirëmbahen në mënyrë të tillë që të ofrojnë sigurinë e njerëzve dhe të pronës.

## **XV. MBROJTJA NGA NDËRHYRJET DHE DËMTIMET**

- 5.1 Operatori i Rrjetit duhet të verifikojë konsumin e Energjisë Elektrike të regjistruar në çdo pikë matje për të përcaktuar konsumin real për Klientët fundor.
- 5.2 Në rast të ndërhyrjeve të paligjshme ose përdorimit të paautorizuar të Energjisë Elektrike, Operatori i Rrjetit do të zbatojë Legjislacionin në fuqi në Territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 5.3 Kur matësi ose pjesë të matësit janë jashtë funksionit apo punojnë jashtë kufijve të lejuar të gabimit, atëherë merren masa për rregullimin, riparimin ose zëvendësimin e tyre duke bërë të mundur kthimin në punë të pajisjes sipas kërkesave të lejuara për kufijtë e gabimit.
- 5.4 Klientët fundorë familjarë ose jofamiljarë do të përdorin me kujdes dhe do ti ruajnë pajisjet e matjes kur ato janë të vendosur brenda kufijve të pronësisë së tyre. Në rast se ata verifikojnë dëmtim të pajisjes matëse atëherë do të lajmërojnë me shkrim subjektin që siguron pajisjet sipas marrëveshjes për ta riparuar ose zëvendësuar.
- 5.5 Klienti i cili nuk ka interes pronësie me pajisjen matëse të instaluar nga një operator i sistemit, nuk duhet të ngacmojë ose të lejojë ngacmime të pajisjeve matëse të instaluara.
- 5.6 Të gjitha matësat e verifikuar janë të vulosur. Vulat përdoren për të identifikuar subjektin që ka kryer verifikimin e matësit dhe ka ofruar siguri për elementet matës të matësit nga ngacnimet.
- 5.7 Fuqia elektrike e përdorur nga klientët duhet të lexohet dhe faturohet nga furnizuesi sipas regjistrimeve të pajisjes matëse.
- 5.8 Çdo ndërhyrje tek matësat e Operatorit të Rrjetit janë të ndaluara dhe ndalohen sipas Legjislacionit në Fuqi.

## **XVI. MODIFIKIMI I KUSHTEVE TË SHËRBIMEVE**

Kontraktori mund të ndryshojë, ose të modifikojë procedurat e shërbimeve duke ndjekur referencat e standardeve, apo modifikimet e kërkuara nga legjislacioni, ose organet akredituese. Në këto raste Kontraktori do të njoftojë paraprakisht Shpërndarësin për këto ndryshime një muaj përpara se të modifikohen.

## **XVII. TARIFAT – PAGESA PËR SHËRBIMET.**

- 17.1 Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe ministrit përgjegjës për energjinë, sikurse përcaktohet në Ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, sikurse përcaktohet në Aneksin 1

- 17.2 Sasia e vulave dhe etiketave të sigurisë që do të vendoset në makinerinë dhe morseterinë e çdo matësi elektrik do të jetë si vijon:
- vulë makinerie copë 1 (një) ,
  - Etiketë sigurie copë 2 (një etiketë në çdo anë të matësit elektrik),
  - Vulë morseterie copë 2 (dy) ku secila palë vendos nga një vulë morseterie gjatë procesit të bashkëvulosjes.
- 17.3 Shërbimi i vulosjes së matësit elektrik ka të bëjë me vulosjen e makinerisë së matësit dhe nuk është pjesë e shërbimit të verifikimit të tij. Tarifa e shërbimit të vulosjes do të përdoret për çdo vulë sigurie makinerie. Çdo çift etiketash sigurie, që do përdoren për vulosjen shitesë së makinerisë të matësit elektrik do të konsiderohet si një vulë e re.
- 9.4 Bashkëvulosja e matësit elektrik ka të bëjë me vulosjen e morseterisë së matësit dhe nuk është pjesë e shërbimit të verifikimit të tij. Tarifa e shërbimit të vulosjes do të përdoret për çdo vulë sigurie morseterie.
- 9.5 Nëse tarifat do të ndryshojnë, atëherë ato do të jenë automatikisht të zbatueshme nga palët.

## **XVIII. FATURIMI – PAGESA – PENALITETET**

### **18.1 Faturimi**

Faturimi i shërbimeve të realizuara në një muaj do të bëhet mbi bazë të një fature tatimore, të lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës.

### **18.2 Dorëzimi i faturës**

Fatura përmbledh të gjitha shërbimet e realizuara në një muaj. Fatura, së bashku me dokumentacionin mbështetës, do të depozitohet tek Shpërndarësi.

### **18.3 Dokumentacioni mbështetës**

Dokumentacioni mbështetës përmban aktivitetin e detajuar mujor sipas shërbimeve të kryera si vijon:

- Fatura tatimore për shërbimet mujore të kryera nga Ofruesi i Shërbimit
- Raport përmbledhës (regjistri) i verifikimeve të matësive 1F dhe 3F të kryera në laborator.
- Raport përmbledhës (regjistri) i verifikimeve të matësive 1F dhe 3F të kryera në terren.
- Raport përmbledhës (regjistri) i bashkëvulosjes së matësive 1F dhe 3F të kryera në terren.
- Përmbledhje mujore e të gjithë aktiviteteve të kryera sipas rajoneve
- Përmbledhjen mujore të shërbimeve të kryera sipas agjensive të rajoneve, të firmosur nga kontraktori dhe kordinatorët e Operatorit të Rrjetit të çdo rajoni në të cilin është kryer shërbimi
- Akt Rakordimi për shërbimet e kryera sipas rajoneve, të firmosura nga kontraktori dhe kordinatorët e Operatorit të Rrjetit të çdo rajoni në të cilin është kryer shërbimi.
- Formulari i faturimit të shërbimit mujor
- Kopje elektronike e dokumentave të përmendura më sipër ku përfshihet edhe Raporti përmbledhës i shërbimeve mujore të kryera (1 kopje CD në format PDF).
- Aktet e pranimit dhe dorëzimit të matësive, si edhe raportet individuale të verifikimit dhe të bashkëvulosjes, nuk do të paraqiten sëbashku me faturën, por do të ruhen në çdo rajon të Operatorit të Rrjetit sipas aktivitetit të kryer.

#### **18.4 Mënyra e pagesave**

Operatori i Rrjetit do të kryejë pagesat e shërbimeve të faturuara nga kontraktori në numrin e llogarisë së kontraktorit:

#### **18.5 Afati i kryerjes së pagesës**

Pagesa e shërbimeve do të kryhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e lëshimit të faturës.

#### **18.6 Penalitete për vonesë pagese**

Për vonesa në pagesa përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 18.5, do të aplikohet një penaltet për vonesë të pagesës në vlerën 0.1% e vlerës së faturës së papaguar për çdo ditë vonesë kalendarike por jo më shumë se vlera e faturës.

#### **18.7 Penalitete të tjera**

18.7.1 Nëse Operatori i Rrjetit, konstaton se matësi elektrik i deklaruar si i verifikuar nuk ka kaluar procesin e verifikimit, Ofruesi i Shërbimit do të ngarkohet me një penaltet prej 1'500 Lekë për çdo rast të konstatuar.

18.7.2 Nëse Operatori i Rrjetit konstaton se matësi elektrik i deklaruar si i verifikuar ka rezultate që nuk janë në përputhje me kërkesat e Standardeve teknike dhe procedurave respektive që lidhen me verifikimin; atëhere Operatori i Rrjetit nuk do të bëjë njohjen e këtyre verifikimeve dhe do të hiqen nga aktet e rakordimit të dorëzuara për këtë qëllim. Korrigjimet që mund të bëjë subjekti i pavarur duhet të shoqërohen me korrigjimet respektive në raportet individuale të dorëzuara si edhe në arkivën e shtypur dhe arkivën elektronike.

18.7.3 Operatori i Rrjetit detyrohet të bëjë tërheqjen e matësive të verifikuar dhe vulosur në laborator brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit nga ana e Kontraktorit, në të kundërt ai gëzon të drejtën e aplikimit të tarifave shtesë për magazinimin dhe ruajtjen e tyre sipas legjisllacionit në fuqi.

18.7.4 Në rast se matësat të cilët nuk janë verifikuar brenda afatit të përcaktuar në pikën XII atëhere Ofruesi i Shërbimit do të ngarkohet me një penaltet në vlerën 1000 lekë për secilin matës të verifikuar tej afatit kohor.

## **18.8 Pezullimi**

Në rast të mos kryerjes, qoftë edhe pjesërisht të detyrimeve, Kontraktori ka të drejtën e pezullimit të ofrimit të shërbimeve deri në kryerjen e pagesës të plotë nga Shpërndarësi, pa patur asnjë lloj përgjegjësie ndaj Operatorit të Rrjetit dhe/ose palëve të treta.

## **XIX. KËRKESA TË TJERA TEKNIKE**

- 19.1 Palët janë përgjegjëse që shërbimet të jenë në përputhje me specifikimet dhe formularët teknike, për të cilat kanë rënë dakord në aneksin e kësaj kontrate.
- 19.2 Proceset e punës të verifikimit të matësave të energjisë elektrike do të jenë në përputhje me kërkesat e standartit IEC 62053, EN 50470 dhe ato të parashikuara në Kodin e Matjes Evidentimi dhe raportimi i testeve të kryera do të bëhet sipas formularëve në Aneksin 6,7,8 dhe 9 të kësaj kontrate.
- 19.3 Terminologjia e përdorur është konform Fjalorit Ndërkombëtar të Metrologjisë.
- 19.4 Tolerancat e lejuara të saktësisë së matësave të energjisë elektrike gjatë verifikimit të tyre do të jenë në përputhje me tolerancat e parashikuara në standartin SSH EN 62053 dhe Kodin e Matjes të cilat janë të paraqitura në Aneksin 23.
- 19.5 Specifikime Teknike të Vulës
  - Vula e sigurisë duhet të ketë këto karakteristika teknike:
    - Të ketë të gjithë elementët e sigurisë për të mbrojtur sistemin e matjes së energjisë elektrike nga ndërhyrjet e personave të tjerë.
    - Duhet të jetë e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse.
    - Çdo përpjekje për të ndërhyrë me anë të ushtrimit të nxehtësisë, forcës mekanike apo kimikateve (tretësve) duhet të jetë e dallueshme nëpërmjet shenjave që lë.
    - Trupi i jashtëm i vulës së sigurisë do të jetë me ngjyrë transparente për të identifikuar ndërhyrjet e mundshme nga jashtë, kurse pjesa tjetër është e lëvizshme dhe realizohet me ngjyrë material të ndryshme.
    - Vula e sigurisë do të ketë të shënuara në trupin e saj këto elementë:
      - Emri i kompanisë që ka vendosur vulën ,
      - Numri serial i vulës i cili është unik, me 6-8 shifra dhe
      - Barkod i cili tregon numrin serial të vulës së sigurisë.
    - Numri serial dhe barkodi duhet të jenë të qëndrueshëm në trupin e vulës duke siguruar mos fshirjen e tyre nëpërmjet fërkimit apo formave të ngjashme.
  - Për efekt sigurie i gjithë numri serial ose 4 shifrat e fundit të numrit serial të vulës korespondojnë me shifrat e gdhendura me lazer në pjesën e lëvizshme të vulës.
  - Vula e sigurisë duhet të funksionojë shumë mirë dhe të ruaj cilësitë e saj teknike edhe në kushte ekstreme të ambientit ( -20°C ÷ + 130°C).
  - Materiali që përdoret për vulën e sigurisë është polycarbonate ose acetal dhe i qëndrueshëm ndaj rrezeve UV.
  - Vula e sigurisë mund të jetë e përbërë nga element sigurie në formën e çipit (RFID)
  - Vulosja nëpërmjet vulës së sigurisë bëhet me tel çeliku të viaskuar dhe galvanizuar.

## **XX. PLANIFIKIMI.**

- 20.1 Palët do të hartojnë planin e realizimit të objektit të kontratës në përputhje me programin e përgatitur nga Shpërndarësi, në bashkëpunim me subjektin e autorizuar dhe të miratuar nga DPM.
- 20.2 Operatori i Rrjetit mban përgjegjësi për krijimin e kushteve dhe realizimin e programit të punës. Nëse programi i punës nuk do të realizohet në një muaj të caktuar të vitit, atëherë diferenca do të realizohet në muajin pasardhës.
- 20.3 Operatori i Rrjetit përgatit planin javor të shërbimeve që do të kryej dhe ja dorëzon paraprakisht subjektit të pavarur të autorizuar që të marrë masat për organizimin e strukturave të tij për të mundur realizimin e këtij planifikimi.
- 20.4 Nevojat e Operatorit të Rrjetit që lidhen me praninë e strukturave të subjekteve të pavarura të autorizuar me qëllim ndërprerjen e energjisë elektrike të klientevë të ndryshëm nuk janë pjesë e shërbimit dhe nuk do të trajtohen nga subjektet e autorizuar.
- 20.5 Nevojat e Operatorit të Rrjetit që lidhen me kontrollin e klientëve për të cilët Operatori i Rrjetit ka dyshime në lidhje me matësin elektrik do të trajtohen nga subjektet e autorizuar bazuar në një plan të detajuar javor, por angazhimi kryesor i subjektit të autorizuar do të jenë shërbimet që lidhen me verifikimin periodik.
- 20.6 Nëse Operatori i Rrjetit ose kordinatori rajonal i tij kërkojnë shërbime të pa planifikuara në planin javor, ose kërkojnë shërbime në rajone apo agjensi të cilat nuk kanë qenë pjesë e planifikimit javor, atëherë këto kërkesa nuk do të konsiderohen nga ana e subjektit të autorizuar.
- 20.7 Shërbimet do të kryhen në laborator dhe në terren. Kontraktori do të kryejë shërbimet në rajonet dhe agjensitë sipas ndarjes së zonave gjeografike në bazë të Udhëzimit të Ministrisë Tregtisë dhe Energjitikes Nr.–datë "Për përcaktimin e numrit të subjekteve të autorizuar për kryerjen e shërbimeve në metrologjinë ligjore" :
- 20.8 Ankesat për verifikimin e saktësinë së matësit të energjisë elektrike do të trajtohen nga ai subjekt i autorizuar i cili nuk ushtron shërbimin e verifikimit në rajonin (agjensinë) nga ku vjen ankesa.
- 20.9 Pavarësisht ndarjes së mësipërme administrative, subjektet e autorizuar kanë të drejtë të bashkëpunojnë midis tyre, apo të mbulojnë zona të dedikuara për subjektin tjetër, pasi të bien dakord me njëri-tjetrin dhe të marrin pëlqimin e Operatorit të Rrjetit.

## **XXI. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE.**

- 21.1 Palët gëzojnë të drejtën e pronësisë intelektuale për efekte të rregullimit të marrëdhënieve që lindin dhe zhvillohen për shkak të saj.
- 21.2 Kur pronësia intelektuale zhvillohet në lidhje me zbatimin e kontratës, atëherë në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër midis palëve, pronësia intelektuale do t'i mbetet palës e cila e zhvilloi atë, gjithmonë me kusht që sipas kësaj marrëveshje, pala tjetër duhet të ketë një licensë të shkruar që të përdorë pronësinë intelektuale pa pagesë me qëllim zbatimin e kontratës.

## **XXII. FORCA MADHORE.**

- 23.1 Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të marrëveshjes në qoftë se ajo shkaktohet nga forca madhore, siç përcaktohet Neni 90 : Situatat emergjente në furnizimin me energji elektrike, të Ligjit Nr. 43 /2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- 23.2 Pala e prekur nga një ngjarje e tillë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për shkallën dhe kohëzgjatjen përafërsisht të kësaj pamundësie për të përmbushur detyrimet e saj dhe të paraqesë brenda 20 ditëve nga njoftimi i dhënë dokumenta të vërtetuara nga organet kompetente në vend.
- 23.3 Me pushimin e vonesave ose të humbjeve që kanë rezultuar nga kjo ngjarje, pala e prekur do të njoftojë palën tjetër për këtë ndërprerje.

## **XXIII. KONFIDENCIALITETI**

- 23.1 Informacionet, korrespondencat dhe çdo dokument tjetër i shkëmbyer mes palëve për shkak të kontratës dhe marrëdhënieve që lindin, ose rregullohen prej saj, do të cilësohen konfidenciale dhe do t'i nënshtrohet prej palëve trajtimit ligjor si material konfidencial dhe nuk do të përdoret përtej qëllimit të tij.
- 23.2 Aksesit dhe konsultimi i dokumentave, që lidhen me shërbimet e kontrollit është i rezervuar për funksionet e përfshira dhe nuk mund t'u bëhen të njohura të tretëve.
- 23.3 Përrjashtohen nga rregulli i mësipërm informacioni ose çdo dokument tjetër
- që është siguruar në mënyrë të ligjshme nga të tretët;
  - që njihet si i ligjshëm për t'u publikuar nga marrësi në ditën e marrjes;
  - që është i lirë në zotërim të publikut.
- 23.4 Nëse informacione që kanë të bëjnë me Operatorin e Rrjetit duhet t'u bëhen të ditura të tretëve për shkak të detyrimeve ligjore, Kontraktori do të informojë Operatorin e Rrjetit në një afat të përshtatshëm.
- 23.4 Klienti mund të kërkojë raportet e testimi të matësit elektrik duke ju drejtuar Operatorit të Rrjetit dhe nuk ka të drejtë të kërkojë raportet tek subjekti i autorizuar ose akredituar i cili ka kryer shërbimin e verifikimit të matësit elektrik.
- 23.5 Subjekti i autorizuar do të ketë arkivën e tij për shërbimet e kryera në formë të printuar dhe në formë elektronike. Arkiva e printuar do të ruhet në një ambient të sigurtë dhe mund të shkatërrohet vetëm pasi të kenë kaluar 3 vjet nga koha e kryerjes së shërbimit. Arkiva elektronike do të administrohet në databasë të subjektit të autorizuar dhe do të jetë plotësisht e disponueshme pa kufizim kohor. Është përgjegjësi e subjektit të autorizuar që të garantojë përputhshmërinë e arkivës së printuar dhe dorëzuar me arkivën elektronike që ruhet në server të vetë subjektit të autorizuar.

## **XXIV. AFATI, HYRJA NË FUQI DHE VLEFSHMËRIA**

- 24.1 Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e nënshkrimit të saj dhe jo më shumë se 3 (tre) vjet, me të drejtë përsëritje. Nëse Shpërndarësi nuk njofton me shkrim kontraktorin tre muaj



përpara përfundimit të afatit dy vjeçar, kontrata konsiderohet e rinovuar automatikisht edhe për një vit tjetër.

- 24.2 Pas mbarimit të këtij afati palët kanë të drejtë të nënshkruajnë një kontratë të re në zbatim të ligjit. Tre muaj përpara mbarimit të kësaj kontrate, palët fillojnë negociatat për rinovimin e saj.

## **XXV. PËRFUNDIMI, NDËRPRERJA E KONTRATËS**

25.1 Kontrata përfundon nëse:

- plotësohet afati i vlefshmërisë i parashikuar në Nenin 24.1;
- Autorizimi i dhënë me Vendim Administrativ të DPM, nuk rinovohet, tërhiqet apo skadon përpara afatit të parashikuar në pikën 24.1
- ndonjëra nga palët njofton 60 ditë përpara ndërprerjen e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në këtë marrëveshje;
- ndonjëra nga palët ose bashkarisht mbyllin aktivitetin para afatit me vendim gjykate për arsye të parashikuar në legjislacionin shqiptar.
- për shkak të ndryshimeve në legjislacion

25.2 Palët mund të ndërpresin në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën vetëm kur njëra nga palët:

- Nuk kryen pagesën brënda afateve të parashikuara në këtë kontratë;
- Shkon drejt likuidimit ose është deklaruar në falimentim;
- Nuk respekton dhe/ose nuk zbaton në mënyrë të përsëritur kushtet e kontratës.
- Si pasojë e një vendimi të formës së prerë të gjykatës

25.3 Përfundimi i kësaj kontrate nuk shuan detyrimet e mbartuara midis palëve gjatë vlefshmërisë së kontratës.

## **XXVI. KALIMI TEK TË TRETËT**

26.1 Kontrata nuk mund të kalohet, transferohet apo tjetërsohet nga palët përveç se kur ky veprim është i ligjshëm dhe në konformitet me të drejtat civile që shoqërojnë ndryshime që mund të ndodhin në pronësinë e ndonjërës palë apo të dyjave së bashku.

## **XXVII. PERSONAT E AUTORIZUAR. NJOFTIMET**

27.1 Çdo palë mund të emërojë ose autorizojë me shkrim një person/disa persona ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e njoftimeve dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës ku duhet të përcaktohet edhe shtrirja e autoritetit të përfaqësuesit.

27.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër brenda 5 ditëve kalendarike për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit/ve të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

27.3 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj kontrate, do të jetë me shkrim ose në formë elektronike.

27.4 Personat e kontaktit

Për të realizuar kontratën dhe për mbarëvajtjen e saj, administratorët e kontratës dhe personat e kontaktit për secilën palë janë:

Kontraktori :

Operatori i Rrjetit :

## **XXVIII. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 28.1 Kjo kontratë dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të do të rregullohen, interpretohen në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 28.2 Çdo mosmarrëveshje mes palëve, pretendim ose kundërshtim në lidhje me këtë kontratë, ose çdo shkelje, pretendim ose pavlefshmëria e saj do të zgjidhen me negociata.
- 28.3 Në rast se mosmarrëveshja ndërmjet palëve, që lidhet me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të matësave, nuk zgjidhet me negociime direkte, atëherë palët i drejtohen DPM të vendosë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
- 28.4 Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera që nuk lidhen me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të matësave, nëse Palët nuk arrijnë zgjidhjen me mirëkuptim pas negociatave brenda 30 ditëve, atëherë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **XXIX. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- 29.1 Çdo ndryshim, modifikim, heqje apo shtim dispozitash i kësaj kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse më parë nuk është rënë dakord me shkrim për këtë nga palët dhe të jetë miratuar nga ERE.

- 29.2 Anekset krijohen në dakortësi të palëve. Anekset mund të ndryshohen, duke rënë dakort me shkrim nga palët, pa kërkuar miratim nga ERE. Anekset asnjëherë nuk tejkalojnë përmbajtjen e kërkesave të përgjithshme.
- 29.3 Kontrata dhe anekset e saj hartohen në gjuhën shqipe, në 2 kopje, nga një për secilën palë.

## PALËT NËNSHKRUESE

Për Operatorin e Rrjetit

Administratori

Për Kontraktorin

Administratori

## ANEKSET

### MBI VERIFIKIMIN E MATËSAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

- Aneksi.1 Lista e çmimeve njësi
- Aneksi.2 Ndarja e Rajoneve dhe Agjensive
- Aneksi.3 Akti i pranimit të matësive për verifikim
- Aneksi.4 Formulari i pranimit të matësive për verifikim
- Aneksi.5 Formulari i dorëzimit të matësive pas verifikimit
- Aneksi.6 Raport testimi individual i matësit njëfazorë 1F klasa 0.5, 1, 2
- Aneksi.7 Raport testimi individual i matësit njëfazorë 1F klasa A, B, C
- Aneksi.8 Raport testimi individual i matësit trefazorë 3F klasa 0.5, 1, 2
- Aneksi.9 Raport testimi individual i matësit trefazorë 3F klasa A, B, C
- Aneksi.10 Raport përmbledhës i matësive të ndryshëm njëfazorë 1F
- Aneksi.11 Raport përmbledhës i matësive të ndryshëm trefazorë 3F
- Aneksi.12 Raport përmbledhës i matësive identikë njëfazorë 1F
- Aneksi.13 Raport përmbledhës i matësive identikë trefazorë 3F
- Aneksi.14 Formulari i raportit të verifikimit të saktësisë së matësive elektrik dhe/ose Bashkëvulosje
- Aneksi.15 Raport përmbledhës i shërbimeve mujore të kryera
- Aneksi.16 Raport verifikimi përmbledhës mujor
- Aneksi.17 Raport përmbledhës mujor për Bashkëvulosje Direkte
- Aneksi.18 Përmbledhjen mujore të shërbimeve të kryera sipas rajoneve.
- Aneksi.19 Përmbledhje e aktivitetit mujor për çdo rajon sipas agjensive
- Aneksi.20 Akt rakordimi për aktivitetin mujor sipas rajoneve
- Aneksi.21 Formulari i faturimit të shërbimit mujor
- Aneksi.22 Lista e kordinatorëve sipas rajoneve
- Aneksi.23 Tolerancat e gabimit të matësit elektrik gjatë verifikimit
- Aneksi.24 Kriteret e pranimit të testimit me përzgjedhje
- Aneksi.25 Bashkëveprimi organizativ midis palëve
- Aneksi.26 Plani i punës vjetor për shërbimet që do të kryhen sipas rajoneve